



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3351/2025
Data : 13.05.2025

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e katër -IV- për vitin 2025 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 22.04.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë , Rini dhe Sport), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Bajrush Laçi** (Udhëheqës i Zyrës Ligjore), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së) , **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025.
3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .
4. Propozim –Vendim për ndarjet e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë Hani i Elezit 2025” –Edicioni i tretë”.
5. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- kërkoj që të hynë në rend të punës, Kërkesë për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025. Arsye për këtë vonesë është sepse nuk kemi mundur ta bëjmë këtë kërkesë për bartje para se pasqyrat financiare vjetore në nivel të Kosovës të publikohen në veb faqe të Ministrisë. Pasi është dërguar materiali për mbledhje të Komitetit për Politikë e Financa Ministria na e a dhënë dritën e gjelbërt që komunat të vazhdojnë me këtë kërkesë. Është në të mirën tonë për shkak se disa projekteve kapitale ju duhet ky financim që të kompletohet

Kryesuesi thekson:- kërkesën për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025 e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025.
3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .
4. Propozim –Vendim për ndarjet e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë Hani i Elezit 2025” –Edicioni i tretë”.
5. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
6. Kërkesë për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025.
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me NR. 08/L-332 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2025 është në lartësi prej 3,615,457.00 €. Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe shtesa 2,188,542.00 €, Mallra dhe shërbime 584,500.00 €, Shpenzimet komunale 94,000.00 €, Subvencione dhe transfere 143,000.00 €, Shpenzime kapitale 605,415.00 €. Totali i buxhetit është në shumë prej 3,615,457.00 €. Ndërsa buxheti përfundimtar është 3,807,629.14 €, ku në këtë shumë përfshihen: Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej 3,275,738.00 €. Projektioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej 339,719.00 €. Mjetet e mbetura nga Donacioni i Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej 15,923.01 €. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 176,135.45 €, 5. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej 113.68 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - mars 2025 është në shumë prej 681,517.35 €. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për tremujorin e parë të vitit 2025 është në shumë prej 560,691.90 € apo 99.85% nga Buxheti i alokuar dhe 25.62% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për tremujorin e parë të vitit 2025 është në shumë prej 96,823.42 € apo 16.17% nga Buxheti i alokuar dhe 14.81% nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Komunale për tremujorin e parë të vitit 2025 është në shumë prej 23,202.03 € apo 24.68 % nga Buxheti i alokuar dhe 24.68 % nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për tremujorin e parë të vitit 2025 është në shumë prej 800.00 € apo 3.90 % nga Buxheti i alokuar dhe 0.56% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Nga kategoria buxhetore Shpenzime Kapitale, përgjatë TM1 të vitit 2025 dhe 2024, nuk ka pasur shpenzim. Projektioni i të hyrave vetanake 2025 është në shumë prej 339,719 €, Realizimi është në shumë prej 37,239.12 €, ndërsa për vitin 2024 realizimi ka qenë në shumë prej 111,374.83 € pra në këtë vit kemi inkasuar 74,135.71 € më pak se në tre mujorin e vitit të kaluar. Në këtë tabelë të hyrat e realizuara për TM1 2025 dhe 2024 janë pa gjokat e trafikut dhe Gjykatave, pasi që nuk kemi pranuar raportin e të hyrave indirekte nga Divizioni i të hyrave – MFPT.

Sherif Berisha thekson:- a ka fatura ende të pa paguara.

Lindita Ballazhi thekson:- ka ende fatura të cilat janë në proces për shkak se kemi pasur obligime edhe nga viti i kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- nga pasqyrat financiare të vitit 2023 i kemi pesë të gjetura. Çështja e parë është vonesa në pagesën e obligimeve financiare. Kjo e gjetur është pjesërisht e zbatuar. Ka raste të cilat pagesa nuk kanë mund të realizohen brenda afatit ligjor. Kjo ka rrjedh për shkak të lëndëve përmbartimore të cilat kanë rrjedh nga kontrata kolektive dhe mjetet janë ekzekutuar pa aprovimin rrjedhimisht. Çështja e dytë ka të bëjë me zotimi i mjeteve dhe urdhërblerjet në SIMFK pas pranimi të faturave. Edhe kjo është pjesërisht e zbatuar ku kemi raste ku nuk dihet vlera e faturës si psh: furnizim me derivate për automjetet zyrtare paraprakisht nuk mund të bëhet zotimi pa ardhur fatura sepse nuk dihet vlera e saktë e furnizimit. Çështja e tretë ka të bëjë me dobësi në menaxhimin e pasurisë kapitale dhe jokapitale, por kjo e gjetur është në proces pasi që Epasuria është funksionalizuar, mirëpo janë disa pasuri që kanë mbetur pa u evidentuar. Çështja e katërt ka të bëjë me rritje e llogarive të arkëtueshme. Është pjesërisht e zbatuar pasi që ne kemi bërë njoftime për pagesën e detyrimeve tatimore, kemi ofruar lidhjen e kontratave me debitorët për pjesën e detyrimeve me këste por normalisht në disa raste nuk kemi mundur i inkasojmë të gjitha llogaritë e arkëtueshme. Çështja e pestë është mos themelimi i njësisë së auditimit të brendshëm. Kjo e gjetur është e pazbatuar gjatë vitit 2024 dhe po vazhdon edhe në vitin 2025 e që edhe gjatë këtij viti nuk do të zbatohet pasi që kemi bërë kërkesa të shtuar numër të stafit por nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk kemi marr përgjigje pozitive kështu që nuk kemi mundur me planifikuar njësinë e auditimit të brendshëm.

Sherif Berisha thekson:- mos pagimi i faturave me kohë drejtoresha përmendi që është një vërejtje pjesërisht e zbatuar por unë mendoj që kjo duhet të ndryshon ndërsa mundësitë për rregullore të brendshme ju duhet t'i shikoni kush do që është përgjegjës për këtë punë në mënyrë që mos me u përsëritur se për çdo vit po vjen e njëjta vërejtje.

Hyriete Isufi thekson:- te e gjetura e pestë ju potencuat që kem bërë kërkesë por nuk na është lejuar por kush e ka shënuar këtë që Kryetari duhet të merr veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores. Ju potencuat që keni bërë kërkesë dhe nuk ju ka lejuar por pse është shkruar që Kryetari duhet të merr veprime.

Lindita Ballazhi thekson:- komponenta e auditimit , gjetja dhe rekomandimi janë të shënuar nga ana e auditorit , ndërsa për veprimet e ndërmarra , data e zbatimit të rekomandimeve dhe komenteve janë pjesa e jonë që e plotëson këtë raport të auditimit, kështu që rekomandimin siç e keni lexuar dhe gjetjen është që janë të shënuara nga ana e auditorit të cilën e kanë dhënë si rekomandim për këtë gjetje që Kryetari duhet të ndërmarr masa apo veprime për themelimin e ndjesisë së auditimit të brendshëm dhe këto masa ne i kemi ndërmarr por nuk kemi pasur përgjigje pozitive. Komuna për të planifikuar pozita të brendshme së pari Ministria duhet të na i aprovon numrin e caktuar të stafit për pozita të lira për shkak se është njësia e auditimit si drejtori në vete. Përgjigje pozitive nuk kemi marr për këtë vit dhe nuk do të jetë e zbatuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI PERIODIK LIDHUR ME PROGRESIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim –Vendim për ndarjet e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë Hani i Elezit 2025 –Edicioni i tretë”.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- vlera e përgjithshme e mjeteve financiare për mbështetje “Ditët e Kulturës dhe Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar Hani i Elezit 2025-Edicioni i Tretë” është në shumë prej 25,000.00 € dhe do të merren nga këto Nën-programe buxhetore dhe nga këto kategori, si vijon: Zyra e Kryetarit (16035), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 11,000.00 €, Shërbimet Kulturore (85035), kategoria mallra dhe shërbime (130), shuma prej 8000.00 €, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (19675), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 500.00 €, Administrata (16335), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 5000.00 €, Turizmi (48075), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 500.00 €.

Arbenita Bajramaliu thekson:- para jush keni materialin me aktivitete për ditët e kulturës, nëse është ndonjë pikë që duhet me u larguar apo shtuar mundeni me propozuar.

Sherif Berisha thekson:- vlera e mjeteve financiare është shumë. Te aktivitetet që drejtoresha i ka paraparë në asnjërin nuk shënon shuma e shpenzimeve. Vitin e kaluar kur është mbajtur festivali ka qenë një shumë prej tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind euro. Te aktivitetet është mirë me bërë diçka ma atraktive dhe që është më e qëndrueshme në nivel të komunës për shkak se unë jam për kulturë de sport por kjo vlerë e mjeteve financiare është e lartë.

Lindita Ballazhi thekson:- shumën të cilën e përmendët nuk ka qenë vitin e kaluar por në vitin 2023 dhe ka dalë jashtë planifikimit.

Arbenita Bajramaliu thekson:- vitin e kaluar komuna ka paguar 14,500.00 € për dreka për festival dhe 8000.00 € janë shpenzuar prej Ministrisë, që do të thotë e ka kaluar shumën. Në këtë vit planifikojmë me pasur edhe një promovim të librit. Nuk kemi shtuar mjete pa e ditur shumën për shkak se në vitin e kaluar janë shpenzuar 22, 500.00 €. Nëse ka diçka që duhet me heqë ju e vendosni por vitin e kaluar ka dalur jashtë planifikimit.

Kryesuesi thekson:- te numri rendorë tetë keni paraparë seancë solemne për datën njëmbëdhjetë qershor propozoj që të hiqet për shkak se seanca solemne mbahet për nderë të ditës së dëshmorëve . Është mirë që me i paraqitur shumat për shpenzimet që planifikohen.

Sherif Berisha thekson:- a keni kontaktuar me ndonjë përfaqësues të klubit të mundjes që i keni paraparë aktivitete.

Arbenita Bajramaliu thekson:- nga pjesëmarrja që ka bërë komuna i kemi nxjerrë këto aktivitete. Te turneu ndërkombëtarë i mundjes vitin e kaluar nuk kemi bërë asgjë.

Nexhmedin Daci thekson:- të gjitha këto aktivitete janë nën patronatin e Kryetarit të Komunës dhe ai pastaj i ndanë punët.

Hyriete Isufi thekson:- kush ka me promovuar librin.

Arbenita Bajramaliu thekson:- kërkesë për promovimin e librit ka bërë z.Shaban Çupi.

Xhevahir Dernjani thekson:- festivali parë kur është mbajtur është miratuar në Kuvend Komunal ndarja e mjeteve financiare dhe fillimisht kemi filluar me gjëra pak më thjeshtë për shkak të buxhetit por duhet ta dimë se festivali mbarë kombëtarë tre ditorë kushton, që do të thotë ka qenë një buxhet i vogël por tash është ngritur por me ndarjen e këtyre mjeteve por është mirë që ta kemi një përmbledhje të mjeteve financiare si Kuvend i Komunës .

Nora Xhoni thekson:- është mirë që ta mbajmë një takim të përbashkët me shefat e grupeve parlamentare dhe me Kryesuesin e Kuvendit me dhënë ide apo propozime për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- nëse keni ndonjë propozim konkret mund të parashtoni dhe nuk është e nevojshme me mbajtur ndonjë takim për këtë çështje. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “DITËT E KULTURËS DHE FESTIVALIN MBARËKOMBËTARË HANI I ELEZIT 2025-EDICIONI I TRETË QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5.Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- si komision i aksionarëve që jemi të themeluar nga Kuvendi i Komunës në takimin që e kemi pasur jemi dekoruar që me ja rritur pagën punëtorëve të NP Pastrimi nga muaji gjashtë duke u bazuar në mjetet financiare që i ka kompania.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINACIAR PËR PERIUDHËN JANAR –MARS 2025 I NPL PASTRIMI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6.Kërkesë për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- të hyrat vetanake të bartura nga viti 2023 në vitin 2024 janë ën shumë prej 133,030.00 €, prej të cilave janë shpenzuar vetëm 124,143.00 € dhe për bartje kanë mbetur vetëm 8,887.00 €. Ndërsa të hyrat e realizuara gjatë vitit 2024 janë në shumë prej 317,021.00 € prej të cilave janë shpenzuar vetëm 155,136.00 €, ndërsa për bartje janë në shumë prej 161,885.00 €. Pra shuma e pashpenzuar nga fondi 21 dhe 22 i vitit 2024 është në shumë prej 170,771.67 € të cilët i bartim në vitin 2025 në këto nën-programe dhe kategori buxhetore si vijon: Mallra dhe shërbime në shumë prej 15,860.96 €, Subvencione dhe transfere në shumë prej 5000 .00 € dhe shpenzime kapitale ne shumë prej 149,910.71 €. Në kategorinë buxhetore mallra dhe shërbime: Buxhetimi (17535), kodi funksional (0112), shuma prej 2,000.00 €, Parandalimi dhe inspektimi i zjarrit (18444), kodi funksional (0721) shuma prej 5,860.96 €, Shërbimet e shëndetësisë primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej 5000.00 €, Arsimi parafillorë –çerdhja (92890), kodi funksional (0911) shuma prej 3000.00 €. Në kategorinë buxhetore subvencione dhe transfero Arsim dhe Shkencë: Administrata (92175), kodi funksional (0980) shuma prej 5000.00 €. Në kategorinë buxhetore shpenzime kapitale: Planifikimi urban dhe inspekcioni (66480) në shumë prej 88,77.67 € në këto projekte kapitale: ndërtimi i trotuareve për këmbësorë në Han të Elezit në rrugën Adem Jashari, Udha e Shkronjave Driton Loku , Paldenicë me kod (53370) në shumë prej 5,500.00 €, shtrimi me kupëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në

Han të Elezit de fshatrat : paldenicë , Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik me kod (53471) në shumë prej 41,693.00 € , asfaltimi i rrugës Eksodi 99 –Hani i Elezit me kod (55037) në shumë prej 8000.00 € , asfaltimi i rrugës Nehat Curri lagja Curri –Dermjak me kod (55048) në shumë prej 33578.67 € . Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050) kodi funksional (0721) shuma prej 1,139.04 € në projektin rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së në Han të Elezit dhe AMF-së në Gorancë me kod (45647) në shumë prej 1,139.04 €. Arsim dhe Shkencë : Administrata (92175) kodi funksional (0980) në shumë prej 60,000.00 € në projektin : investime në pajisje të IT –së në shkollat SHML Dardania , SHFMU Ilaz Thaçi, SHFMU Veli Ballazhi dhe SHFMU Kështjella e Diturisë me kod (56091) në shumë prej 60 000.00 €.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PËR AKTIVITETE E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- a dihet çështja e rrugës në fshatin Gorancë sa ka me zgjatur çështja e bllokimit të rrugës për shkak se nëse merr vendim Ministria besoj që institucionet komunale duhet me u njoftuar. Lipsarët të cilët po vijnë është mirë me diskutuar në Këshillin Komunal për siguri se a ka shënime të sakta për shkak se secila komunë duhet ti evidenton se a janë në skema sociale apo nuk janë. A është i njoftuar institucioni komunal rreth noteres që po funksionon në komunën tonë për shkak se qytetarët nuk kanë njohuri që kemi notere në komunën tonë.

Kryesuesi thekson:- për çështje të rrugës nuk kam njohuri por nëse fillojnë me punuar kontaktojnë me drejtorin dhe besoj që del me një njoftim. Sa i përket lypsarëve është e vërtetë që ka por këto çështje i ka policia. Për çështjen e noteres besoj që janë të njoftuar qytetarët.

Xhevahir Dernjani thekson:- është mirë të shtrohet trotuar nga shkolla në fshatin Paldenicë deri të objekti i pritjes.

Nexhmedin Daci thekson:- do të fillon prej te qendra tregtare ETC rregullimi i trotuarit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:53.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

